VENDIM
Nr.687, datë 31.3.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "RADIO 7"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë RTV" dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat "Radio 7", për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 6.11.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)